

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ndalo rebelët Huthi!" Kina paralajmëron Iranin pas bllokimit të naftës saudite
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/ndalo-rebelet-huthi-kina-paralajmëron-iranin-pas-blokim-it-te-naftes-saudit-i586907
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:35:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ecc473eb7cd004dab325e768fee9f3dc57f2a1e181f270d4e2157606090d4a0
TEKSTI	6c501c28538f32401cd19313adb340ce139f508140d7a1e94e920c9801010843
PAMJA	88d31ffdc050d14c0d1b2022e6cbe0890d9168e3400295dfa601fa1865ae7db6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8249b67aad139603b94c5e47e1ff8675d6793b2b9ad229c524346b546713c8a9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8249b67aad139603b94c5e47e1ff8675d6793b2b9ad229c524346b546713c8a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e Homazh per regjisorin e madh italian Luchino Visconti ne edicionin e 24-t te TUFF-Hoxha takim me perfaqesuesin e ri te OBSH-se ne Shqiperi: Partneritet per zhvillimin e fundit

“Ndalo rebelët Huthi!” Kina paralajmëron Iranin pas bllokimit të naftës saudite



18 Shtator 2026, 17:20Bota TEMA



Teksa konflikti në Lindjen e Mesme zgjerohet, me përfshirjen gjithnjë e më aktive të rebelëve Huthi, Kina hyn në lojë për të qetësuar situatën. Burime të cituara nga Reuters pretendojnë se Pekini i ka kërkuar privatisht Teheranit të ndihmojë për të frenuar rebelët Huthi.

Ndërhyrja vjen pas kërkesës që Arabia Saudite i bëri Kinës javën e kaluar, pasi milicia jemenite përparoi me shpejtësi përgjatë Detit të Kuq dhe rreth ngushticës së Bab el-Mandeb, duke intensifikuar edhe sulmet ndaj infrastrukturës energjetike të këtij shteti. Kjo lëvizje i ka bërë eksportet dhe transportin e naftës saudite më të ekspozuara.

Publikisht, Kina ka bërë thirrje për përmbajtje, dialog dhe rikthim të lundrimit të sigurt, por në mesazhin privat, sipas burimeve, ka shkruar edhe më tej. Siç thuhet, Pekini dëshiron të përdorë influencën e vet tek Huthit për të parandaluar përhapjen e konfliktit edhe në rrugë të tjera të rëndësishme të naftës, nga të cilat varet ekonomia e dytë më e madhe e botës.

Sipas burimeve, përgjigjja e Teheranit ishte se stabiliteti dhe paqja në rajon vareshin nga fundi i luftës me SHBA-në dhe Izraelin.

Ndërkohë, autoritetet italiane bënë me dije se një avion luftarak italian Eurofighter F-2000 është goditur dhe dëmtuar gjatë një sulmi ndaj bazës ajrore të Ta'ifit, në Arabinë Saudite, ku ndodhet edhe personel ushtarak italian.

Baza, e cila është ndër qendrat më të rëndësishme operative të Forcave Mbretërore Ajrore Saudite, është vënë vazhdimisht në qendër të sulmeve.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[I dërguari amerikan: SHBA-ja po "shkon në drejtimin e duhur" me Bjellorusin](#)

14:30 Bota / 1 koment

Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik

14:10 Bota

[Fico: Nuk dua që Slovakia të përfshihet në luftë për shkak të Nenit 5 të NATO-s](#)

13:40 Bota / 6 komente

[Polonia: Rusia po përgatitet për sulme me raketa edhe ndaj aleatëve të Ukrainës](#)

13:20 Bota / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.